



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1189/4 Prot.

Tiranë, më 19 / 11 / 2018

### V E N D I M

#### **Nr. 232 , Datë 19 / 11 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 131, datë 31.08.2018, të paraqitur nga D.F kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës<sup>1</sup>” dhe “ngjyrës”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I :

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se në portalin “Mësues për Shqipërinë” të vitit 2017 për lëndën Gjuhë Shqipe-Letërsi është renditur në vend të tretë me 68.7 pikë. Në Nëntor 2017 është emëruar si mësuese e përkohshme në Shkollën 9-vjeçare “Kamenicë” dhe kur të krijohet një vend vakand duhet të kalonte automatikisht si definitive, gjë e cila nuk është zbatuar për shkak të racës. Ankuesja deklaroi se kur i vjen radha për tu emëruar i thonë se nuk ka vende të lira dhe duhet të mbartë pikët tek portali tjetër ndërkohë që mësues të tjerë emërohen direkt me ngarkesë të përhershme.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit.

<sup>1</sup>Subjekti ankues i përket komunitetit Egjiptian të Shqipërisë.

– Referuar Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë që bazohet se shkaqet si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, që justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi për shkak të racës është një nga shkaqet për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 1189/1 prot., datë 04.09.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektivit, DAR Korçë, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga D.F.

Me shkresën nr.462/1, datë 12.09.2018, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, DAR Korçë, në mes të tjerash ka informuar se: *“Punësimi si mësues në arsimin*

---

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

*parauniversitar funksionon sipas Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të MARS “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, konkretisht kreu VII dhe IX udhëzon se me lirimin e një vendi pune, fillimisht trajtohen mësuesit që i nënshtrohen lëvizjes paralele të detyruar kur ngelen pa ngarkesë mësimore, më tutje trajtohen mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele me dëshirë dhe në fund mësuesit konkurues në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Gjithashtu duhet pasur parasysh dhe pika 9 e kreu VII ku thuhet se nuk pranohet dorëheqja e një drejtuesi shkollë derisa ai të rregullohet si mësues me ngarkesë të plotë në mënyrë definitive. Bazuar dhe tek normativa rregulluese e punësimit në arsim ju informojmë se radha e punësimit në arsim tek një pozicion definitiv është si më poshtë: - Fillimisht trajtohen drejtorët që kanë dhënë dorëheqje, - Pas tyre trajtohen mësuesit që kanë ngelur pa ngarkesë mësimore si rezultat i rënies së numrit të orëve, - Më tutje trajtohen mësuesit që kanë paraqitur kërkesë për të lëvizur paralelisht me dëshirë, - Nëse nuk ka të tillë, trajtohen mësuesit fitues në portal që janë emëruar me kontratë të përkohshme, - Kur janë trajtuar kategoritë e mësipërme ose nuk ka kërkuar që plotësojnë kushtet e mësipërme, punësohen mësuesit kandidatë nga portali të papunësuar më përpara. Në vitin shkollor 2017-2018 kemi pasur dy raste lirimi vendi pune të përhershëm të plotësuar nga fitueset e vendit të parë dhe të dytë të portalit. Fituesja e vendit të parë është emëruar fillimisht me kontratë të përkohshme tek shkolla “Vreshtas” dhe më tutje i është ofruar pozicioni definitiv tek shkolla “Goricë e Vogël” sipas kushteve të Udhëzimit 38/2015, Kreu IV, pika 8. Ndërkohë vendet e përkohshme janë plotësuar me kandidatët e radhës të portalit. Konkretisht D.F është emëruar në vitin 2016 me kontratë të përkohshme tek shkolla “Bregas” dhe në vitin 2017 me kontratë të përkohshme tek shkolla “Kamenicë”. Ndërkohë nuk ka pasur mundësi të tjera rregullimi në vend të përhershëm. Në lidhje me portalin 2017-2018 ju bëjmë me dije se procedura e emërimit ka ndryshuar dhe kandidati fitues i një vendi pune lajmërohet direkt prej Ministrisë së Arsimit nëpërmjet postës elektronike duke shmangur krejtësisht DAR Korçë”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm të ankueses nga DAR Korçë.**

Ankuesja, D.F në portalin “Mësues për Shqipërinë” të vitit 2015-2016, ka qenë e renditur në vend të tretë në profilin, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se në vitin shkollor 2016-2017, Komisioni i Vlerësimit të DAR Korçë ka rekomanduar mësuesit: B.Xh dhe P.L të renditur në vend të parë dhe të dytë të portalit, për tu punësuar si mësues me ngarkesë të përhershme në lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, në shkollat 9-vjeçare: “Mësonjëtorja e parë shqipe” dhe Gjymnazin Maliq.

Ankuesja, D.F në portalin “Mësues për Shqipërinë” të vitit 2016-2017, ka qenë e renditur në vend të tretë në profilin, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi. Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se në

vitin shkollor 2017-2018, Komisioni i Vlerësimit të DAR Korçë ka rekomanduar mësuesit: M.J dhe P.V të renditur në vendin e parë dhe të dytë të portalit, për tu punësuar si mësues me ngarkesë të përhershme në lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, në shkollat 9-vjeçare: “Goricë e Vogël” dhe “Vithkuq”.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, rezulton se D.F si mësuese e renditur në vend të tretë në portalin e vitit 2015-2016, në datë 31.10.2016 ka qenë e punësuar si mësuese e profilit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi me ngarkesë të përkohshme në shkollën 9-vjeçare “Bregas”, ndërsa nga data 13.11.2017 deri në datë 12.05.2018 ka qenë e punësuar si mësuese e profilit Gjuhë Shqipe dhe Letërsi me ngarkesë të përkohshme në shkollën 9-vjeçare “Kamenicë”. Në renditjen e portalit “Mësues për Shqipërinë” 2018, D.F rezulton e renditur në vendin e 6 në profilim Gjuhë Shqipe dhe Letërsi.

Në nenin 57/4 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: *“Mësuesi i arsimit fillor dhe i arsimit të mesëm ka të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit pasi të ketë kryer me sukses praktikën profesionale dhe të ketë kaluar provimin e shtetit, siç parashikohet në ligjin nr.10171/2009 “Për profesionet e rregulluara në RSH” të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij”.*

Në Kreun 1, pika 4 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar” përcaktohet se: *“Kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit marrin pjesë në konkurim, i cili zhvillohet në tri faza: A. Konkurrim me dosje. B. Konkurrim nëpërmjet testimit “Mësues për Shqipërinë”. C. Zgjedhja e vendit të punës”.* Ndërsa në Kreun 4, pika 2 “Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesit” të këtij udhëzimi përcaktohet se: *“2. “Kandidati me numrin më të madh të pikëve ftohet nga komisioni dhe zgjedh një nga vendet e lira të punës (me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme), sipas preferencës së tij, në prani të drejtorëve të institucioneve arsimore ku janë vendet e lira të punës”.*

**Referuar legjislacionit të sipërcituar dhe procedurave të kërkuara, arrihet në përfundimin se për tu punësuar si mësues me ngarkesë të plotë apo të pjesshme, të përkohshme apo të përhershme në institucionet e arsimit parauniversitar duhet të respektohen procedurat e caktuara në Udhëzimin nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, procedurë e cila është respektuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të DAR Korçë, për emërimet e kryera për vendet vakante në lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi në rastin e emërimit të mësuesve, M.J dhe P.V të renditur në vendin e parë dhe të dytë të portalit 2016-2017.**

Nga dokumentet e administruara gjatë trajtimit të ankesës, dhe shpjegimet e dhëna nga DAR Korçë, lidhur me pretendimin për diskriminim për shkak të racës, vlerësohet se D.F ka patur marrëdhënie

punësimi<sup>3</sup> me ngarkesë të përkohshme me disa shkolla të DAR Korçë që prej vitit 2016. Pra, vlerësohet se nuk ka patur veprime, paragjykime apo trajtim të pabarabartë të D.F nga ana e Komisionit të Vlerësimit të DAR Korçë.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj ankueses ka një sjellje diskriminuese nga ana e DAR Korçë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>4</sup> dhe trajtimin të pafavorshëm të ankueses.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

---

<sup>3</sup> Deklaratë e ankueses D.F, datë 31.10.2016 që pranon vendin e lire të punës në shkollën Bregas.

Deklaratë e ankueses D.F, datë 13.11.2017 që pranon vendin e lirë të punës në shkollën Kamenicë.

<sup>4</sup> Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në mungesë të një trajtimi të pafavorshëm, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e drejtuesve të Drejtorisë Arsimore Rajonale, Korçë në drejtim të punësimit të ankueses D.F.

**Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se veprimet e DAR Korë në drejtim të marrëdhënieve të punësimit të D.F nuk kanë qenë të pafavorshme.**

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases D.F nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë për shkak të racës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**